

Mbi 15 mijë gra dhe vajza janë vrarë në Siri që nga viti 2011 kur filloi lufta civile në këtë vend, raporton Anadolu Agency (AA).

Organizata për Monitorimin e Respektimit të Drejtave të Njeriut në Siri (SNHR), me rastin e 25 nëntorit, Ditës Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Grave publikoi një raport ku thuhet se që nga marsi 2011 në Siri janë vrarë mbi 15.372 gra, duke përfshirë edhe 4.194 vajza të mitura.

Në mesin e viktimave 641 gra janë vrarë nga snajperistët apo gazrat toksike, ndërsa, siç thuhet në raport, gratë përbëjnë gjashtë për qind të numrit të përgjithshëm të të vrarëve në Siri.

SNHR po ashtu ka theksuar se pjesëtarët e organizatës ISIL në qytetet siriane Hama, Deyru'Zota dhe Rakka vranë 81 femra, në mesin e të cilave pesë ishin vrarë me gurë.